



Vendimi Nr.20/24  
Datë: 26.02.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 26.02.2024, mori këtë;

## V E N D I M

**I. LEJOHET.** Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm nga PV Group mbi Fortenova Group, përmes Open Pass Limited.

**II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55.1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

### Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 15.12.2023, me Nr. Prot. 617/23-01/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm nga PV Group mbi Fortenova Group, përmes Open Pass Limited.

### Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 16.01.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 17.01.2024
3. Palët kanë nënshkruar Marrëveshjen me 29 Nëntor 2023 e lidhur mes Open Pass Limited, BidoCo, BidCo STAK, TopCo dhe Fortenova Group.

### Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshja e nënshkruar me 29 Nëntor 2023 e lidhur mes Open Pass Limited, BidoCo, BidCo STAK, TopCo dhe Fortenova Group.

**Open Pass Limited**, një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të shtetit Malta, me selinë e saj në 53, Office 2, rr. Sir Adrian Dingli, Sliema Slm 1902, Malta dhe me numër regjistrimi nr. C 95571,

**Fortenova Group TopCo B.V. ("TopCo")** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të Holandës, me seli në Herikerbergweg 238, Luna Arena, 1101 CM Amsterdam, Postbus 23393, 1100DW Amsterdam dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të Dhomës së Tregtisë Holandeze me numër regjistrimi 71635416.

**Fortenova Group MidCo B.V. ("MidCo")** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të Holandës, me seli në Herikerbergweg 23Luna Arena, 1101 CM Amsterdam, Postbus 23393, 1100DW Amsterdam dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të Dhomës së Tregtisë Holandeze me numër regjistrimi 75572435.

**Iter BidCo B.V. ("BidCo")**, një shoqëri sapo e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të Holandës, me seli në Herikerbergweg 238, Luna Arena, 1101 CM Amsterdam, Postbus 23393, 1100DW Amsterdam dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të Dhomës së Tregtisë Holandeze me numër regjistrimi 91376432.

**Iter STAK Stichting ("BidCo STAK")**, një shoqëri sapo e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të Holandës, me seli në Herikerbergweg 238, Luna Arena, 1101 CM Amsterdam, Postbus 23393, 1100DW Amsterdam dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të Dhomës së Tregtisë Holandeze me numër regjistrimi 91369436.

**Fortenova Group HoldCo B.V. ("HoldCo")** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të Holandës, me seli në Herikerbergweg 238, Luna Arena, 1101 CM Amsterdam, Postbus 23393, 1100DW Amsterdam dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të Dhomës së Tregtisë Holandeze me numër regjistrimi 71642412.

**Fortenova grupa d.d. ("Fortenova Grupa")**, një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Kroacisë, me seli në rr. Marijana Cavica 1, Zagreb dhe numër regjistrimi 081179147.

#### **Tregu përkatës:**

**Tregu i produktit:** përfshinë furnizimin me: vajra ushqimorë (vaj ulliri, vaj i papërpunuar, i rafinuar, i paketuar, etj.) mish i përpunuar, erëza/salca të ftohta (ketchup, majonezë, margarinë) pije joalkoolike (sode, ujë në shishe) bushje për bukë (djathë ABC) etj.



**Tregu gjeografik:** në transaksionin e propozuar sipas palës mund të lihet i hapur.

### **Analiza e konkurrencës**

Në bazë të analizave të tregut, pra tregut për ofrimin e shërbime të produkteve ushqimore në Kosovë është treg mjaftë konkurrues pasi ka një numër të madh të kompanive distribuese të cilët merren me distribuimin e vajra ushqimorë (vaj ulliri, vaj i papërpunuar, i rafinuar, i paketuar dhe produkteve të tjera ushqimore si mish i përpunuar erëza/salca të ftohta (ketchup, majonezë, margarinë), pije joalkoolike (sode, ujë në shishe). Mbushje për bukë (djathë ABC), pije me bazë kakao, mbushje/salca të ëmbëlsirave, yndyrna bimore etj. Prandaj sa i përket shkallës së koncentrimin në këtë sektorë mund të themi që është mjaftë i ulët.

Transaksioni i Propozuar nuk do të paraqet asnjë shqetësim të konkurrencës në Kosovë pasi që PV Group nuk ka prezencë apo aktivitete në Kosovë dhe nuk gjeneron të hyra nga ofrimi i mallrave apo shërbimeve për konsumatorët që ndodhen në Kosovë.

### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se njëra palë në transaksion është prezentë përmes distributorit të saj të autorizuar në Republikën e Kosovës. Transaksioni i propozuar nuk paraqet ndonjë shqetësim për konkurrencën dhe konsumatorët në Kosovë. Përqendrimi i Propozuar nuk do të rezultojë në asnjë ndryshim në strukturën e tregut relevant në Kosovë. PV Group nuk ka prezencë apo aktivitete në Kosovë dhe nuk gjeneron të hyra nga ofrimi i mallrave apo shërbimeve për konsumatorët që ndodhen në Kosovë. Fortenova në mënyrë të ngjashme nuk ka prezencë lokale dhe është vetëm aktiv përmes distributorëve të saj. Si i tillë, Përqendrimi i Propozuar nuk do të ndryshoj strukturën ekzistuese të tregut në Kosovë, andaj transaksioni i propozuar nuk do të çojë në parandalim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në Kosovë, në veçanti nuk do të çojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese dhe nuk do të ketë asnjë efekt negativ në tregun kosovar. Bazuar në sa më sipër, rezultojnë se transaksioni i propozuar nuk do të ndikojë në konkurrencën në Kosovë dhe se është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

**Shënim:**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare

Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare

Nafije Osdauta  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi Loku  
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva